

Informacioni për kandidatët që do të marrin provimet e njohurive të gjuhës norvegjeze dhe njohurive shoqërore

Paraqitja në provim:	Ju duhet të paraqiteni në kohë të saktë për provim. Kandidatët që vijnë me vonesë, do të refuzohen. Shih informacionin në lidhje me kohën dhe vendin e paraqitjes, në letrën e dërguar nga vendi ku do të mbahet provimi.
Letërnjoftimi:	<p>Ju duhet ta tregoni një letërnjoftim të vlefshëm dhe të nën shkruheni/firmosni në listën e kandidatëve, kur keni arritur te lokali i mbajtjes së provimit.</p> <p>Letërnjoftim i pranuar është:</p> <ul style="list-style-type: none">• Pasaportë e vlefshme• Patentë norvegjeze e shoferit - origjinale dhe kopje e saj• Karta e identitetit (ID) e lëshuar nga Posta, pas 1 prillit 2003• Kartela kombëtare e identifikimit(ID) e lëshuar brenda regjionit EEA(Bashkëpunimi ekonomik evropian)• Pasaporta e udhëtimit për refugjatë dhe pasaporta për të huaj• Karta e qëndrimit për të huaj• Dokument i azilkërkuesit me emrin e tij dhe informatën për vendin e lindjes
Emri:	Kur ju nën shkruheni/firmosni në listën e kandidatëve, duhet ta kontrolloni që emri i juaj, adresa dhe numri ID(identifikimit) janë të shkruara saktë.
Vërtetimi i pagesës:	Nëse keni paguar për provim me faturë ose në mënyrë të drejtpërdrejtë vendit të mbajtjes së provimit, duhet ta tregoni vërtetimin e pagesës kur të vini në provim. Nëse keni paguar me kartë banke, nuk keni nevojë ta tregoni vërtetimin e pagesës.
Mjetet ndihmëse:	Ju nuk mund të përdorni asnjë mjet ndihmës gjatë provimit. Kjo do të thotë që ju nuk mund të përdorni internetin ose dokumentet e arkivuara në kompjuter. Ju nuk mund të komunikoni gjatë provimit me askënd tjetër përveç rojeve ose udhëheqësve të provimit. Kjo llogaritet si kopjim.
Plagjiaturë:	Tekstet që i shkruani në pjesën e provimit me shkrim, duhen të jenë puna e juaj. Plagjiatura nuk lejohet. Nëse ju keni përdorur tërë tekstin ose një pjesë të teksteve të dikujt tjetër (për shembull nga Interneti, tekstet shkollore, ose nga nxënësit tjerë) dhe paraqitur ato si puna e juaj, kjo do të konsiderohet si plagjiaturë, dhe ju nuk do të merrni një vlerësim të pjesës së provimit.
Mjetet e shkrimit:	Ju nuk mund të përdorni mjetet e juaja për të shkruar, por juve mund të ju jepet lapsi dhe letra, nëse ju dëshironi. Letrën duhet ta dorëzoni para se të largoheni nga lokali.
Telefoni mobil/celulari:	Ju duhet ta fikni telefonin mobil plotësisht, dhe ta lëni larg prej juve gjatë provimit. Ju nuk mund ta keni atë në xhepin tuaj ose në vendin tuaj. Nëse një kandidat, kapet me telefon mobil gjatë provimit, kjo konsiderohet si

një tentativë për të kopjuar.

Sëmundja:

Nëse jeni i sëmurë, ju duhet t' i dërgoni ose dorëzoni një vërtetim nga mjeku ose një vërtetim të pushimit mjekësor, vendit të mbajtjes së provimit brenda shtatë(7) ditësh, pas datës së provimit. Atëherë mund të regjistroheshi falas në provimin e ri më vonë.

Kopjimi:

Ju nuk mund të përdorni asnjë mjet ndihmës gjatë provimit. Përdorimi i mjeteve ndihmëse ose tentativa e përdorimit, konsiderohet si kopjim.

Shembuj të tentativës së kopjimit mund të jenë

- Përdorimi i mjeteve ndihmëse elektronike dhe telefonit mobil
- Kopjimi i plotë ose i pjesëve të përgjigjes së dikujt tjetër
- Përdorimi i letërnyoftimit të falsifikuar
- Përdorimi i fjalorit ose i shënimeve të marruara me vete
- Komunikimi me dikën tjetër përveç punonjësve në vendin e testimit, gjatë mbajtjes së provimit

Kopjim, ose tentativa e kopjimit, çojnë deri te

- Ju dëboheni nga lokali
- Ju nuk merrni dëshmi të provimit, për pjesët e provimit që keni marr në periudhën e provimit(kjo vlen si për provimin me shkrim po ashtu edhe për provimin me gojë)
- Ju duhet të paguani për provim, kur të merrni provimin herën tjetër

Kopjimi mund të zbulohet gjatë provimit, pas provimit ose gjatë censurimit të provimeve.

Vërtetimi për marrjen e provimit:

Vendi që administron provimin, dërgon vërtetimin që kandidati ka marr provimin, në adresën që është e shënuar në listën e kandidatëve. Ju duhet të njoftoni vendin që administron provimin, nëse keni një adresë të re.

E drejta e ankesës:

Ankesa në lidhje me rezultatin: Ju keni të drejtë të ankoheni në rezultatin e provimit me shkrim(provimi i gjuhës norvegjeze). Afati i fundit për ankesë është tri javë pasi që është shpall rezultati i censurimit.

Ankesa për gabime procedurale gjatë realizimit të provimit: Ju mund të ankoheni në gabime procedurale gjatë realizimit të provimit të njohurive shoqërore, në provimin e gjuhës norvegjeze me gojë dhe në pjesët e provimit, në të kuptuarit e leximit, kuptimin duke dëgjuar dhe të provimit me shkrim. Afati i fundit për ankesë është tri javë pas mbajtjes së provimit. Shih informacion në lidhje me ankesën në www.norskprøven.no dhe www.samfunnskunnsksprøven.no .

Para se të fillojë provimi, ju keni mundësi për të bërë pyetje praktike. Nëse ju nuk i kuptoni detyrat në pjesën e provimit me shkrim, ju mund të pyesni udhëheqësin e provimit.